



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:246464

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05423012

P.nr.1245/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale, kundër të akuzuarit Xh.B., nga Prizreni, rruga '.....i' nr., për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/II.nr.2023-7/23 të datës 23.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të dëmtuarve Rr.D., dhe A.K., të akuzuarit Xh.B., dhe mbrojtësit të tij av. S.M., me datë 23.01.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa përpiloi me shkrim me datë 29 shkurt 2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuarit:

Xh.B., nga i ati dhe e ëma, mbiemri i vajzërisë së nënës, i lindur me datë, në Prizren, me banim në rrugën '.....' nr., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike- shfrytëzues i ndihmës sociale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 02.11.2023, rreth orës 11:42 min, në rrugën 'Remzi Ademaj' në Prizren, me dashje me anë të forcës dhe kanosjes serioze pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, inspektorët komunal- të dëmtuarit: RR.D., dhe A.K., në atë mënyrë që, pasi i pandehuri kishte vendosur tezgën e tij për pjekje dhe shitje të gështenjave në hapësirën publike (trotuar) pa pasur leje nga organet kompetente komunale, i afrohen inspektorët duke i kërkuar që të liroj hapësirën publike, në atë moment i pandehuri revoltohet dhe i'u drejtohet me fjalët "ju jeni kastraveca, jav thej turit, nuk ju jap letërnjoftimin, nuk jeni kerkushi me më legjitimua", e kur inspektorët i'a tregojnë ID-të, i pandehuri me sjellje agresive vazhdon të kundërshtojë urdhrin e inspektorëve për largim të mallrave dhe lirim të hapësirës publike veprim i cili detyron inspektorët që të kërkojnë asistim të policisë, e kur aty arrijnë policia, i pandehuri e jep letërnjoftimin, kurse inspektori RR.D., fillon ta plotësojë procesverbalin, në atë çast i pandehuri e kap për krahu inspektorin Rr duke tentuar që t'ia merr letërnjoftimin, në prezencë të Policisë, të dy inspektorëve i'u drejtohet me fjalët kanosëse "sa ta përfundoj me

policinë kam pune me juve dyve”, me të cilat veprime pengon zyrtarët policor ti kryejnë detyrat e tyre zyrtare.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së dhe nenet 242, dhe 365 të KPPRK-së të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Duke i vërtetuar dënimin me burg ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër te re penale.

I akuzuari lirohet nga pagesa për shpenzimet penale të procedurës, pasi është shfrytëzues i ndihmës sociale.

Të dëmtuarit zyrtarët policor A.K., nga fshati Malësi e Re, Komuna e Prizrenit dhe RRR.D., nga fshati, Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridik- civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Prizren i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.2023-7/23 të datës 23.11.2023, kundër të akuzuarit Xh.B., nga Prizreni, për shkak te veprës penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 23.01.2024 ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën i akuzuari Xh.B., pas udhëzimeve të dhëna nga gjyqtari i vetëm gjykues, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, në konsultim me mbrojtësin e tij av. S.M., vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Xh.B., duke kërkuar nga gjykata ti shqiptoi një dënim përkatës me rrethana lehtësuese dhe rënduese.

I dëmtuari RR.D., i bashkëngjitet fjalës se prokurorit dhe ka theksuar se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndonjë dëm material, mirëpo në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë atakimi i autoritetit të personit zyrtar andaj gjykata ta ketë për bazë këtë rrethanë me rastin e matjes së dënimit, gjithashtu ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

I dëmtuari A.K., në tërësi e ka mbështet fjalën e kolegut parafolës, dhe ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Avokati mbrojtës S.M., ka deklaruar se pajtohet me deklarinimin lidhur me pranimin e fajësisë se mbrojturit tim pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë vullnetarisht nga se paraprakisht është konsultuar me mua si mbrojtës dhe ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj i ka propozuar gjykatës, që ta pranoj pranimin e fajësisë, nëse gjykata do të aprovoje pranimin e fajësisë propozo që me rastin e matjes se dënimit, llojit dhe

lartësisë së njëjtit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese nga neni 70 pr.3 të KPK si dhe te i zbusë dënimin në kuptim të nenit 71, pasi që i mbrojturi i im, e ka pranuar fajësinë, është i gjendjes se varfër ekonomike dhe jeton nga ndihmat sociale, e që këtë fakt gjykata do ta vërtetonte edhe tani në seancë me rastin e shqimit dhe dorëzimit të kartonit të ndihmës sociale e po ashtu i mbrojturi i im duke potencuar gjendjen e dobët materiale është pa shtëpi dhe jeton në strehimore, është përdorur për veprën ka kërkuar falje premtori që asnjëherë nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale.

I akuzuari Xh.B., ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi si ne aktakuzë duke kërkuar nga gjykata ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 lidhur me 241 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuarit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 241 e 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës si: raporti i oficerit 2023-GA-2473, datë 02.11.2023, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit Xh.B., dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren me datë 03.11.2023 në prezencë të mbrojtësit të tij av. V.Sh., , procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit/ dëshmitarit A.K., dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren me datë 21.11.2023, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit/ dëshmitarit RR.D., dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren me datë 21.11.2023, procesverbal për inspektimin e kryer nr.0002127 datë 02.11.2023 dhe shkresat tjera në lëndë, ka vërtetuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj kjo gjykatë duke u bazuar në këto që u thanë më lart vërtetoi gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 par.1 të KPRK-së, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të neneve 69, 71 dhe 72 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese, pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, rrethanat personale se është i gjendjes së dobët ekonomike – bartës i ndihmës social, i ati i katër fëmijëve. Si rrethana renduese ka gjetur shkallen e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, dhe se vepra penal është kryer ndaj personave zyrtar, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Andaj nga këto të theksuara gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së

gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, me rrethanat personale dhe shkallen e përgjegjësisë të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, e mori në kuptim të nenit 452 par.4 të KPPRK-së.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.1245/2023 i datës 29 shkurt 2024

G j y q t a r i
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë(30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.